

AKT THEMELIMI
I
SHOQËRISË ME PËRGJEGJESI TE KUFIZUAR
FAMA TECH SH.P.K.

Sot, më datë 02/05/ 2025

Elvis FAMA, lindur ne Durres i datëlindjes 22.10.1995, madhor dhe me zotesi te plote per te vepruar, me numër identifikimi JS10220700

ka përpiluar këtë Akt themelimi të Shoqërisë tregtare "FAMA TECH " SH.P.K., me termat e mëposhtme:

NENI 1

Shoqëria Tregtare "FAMA TECH " SH.P.K., themelohet në formën e një Shoqërie me përgjegjësi të kufizuar, në përputhje me ligjin 9901, datë 14/04/2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", (këtu e më poshtë **Shoqëria**).

Shoqëria është një person juridik Shqiptar.

NENI 2

Emri dhe vula e shoqërisë

Shoqëria, do të dalë në qarkullimin juridiko - civil me emrin " FAMA TECH " SH.P.K. Ajo do të ketë edhe vulën e saj.

NENI 3

Objekti i veprimtarisë

Veprimtaria e shoqërisë është:


Krijimi dhe instalimi i programeve software, krijimi dhe instalimi i pajisjeve elektronike hardware, instalime elektrike, kondicionimi, etj. Shërbime mbështetese ne IT.

Riparime te pajisjeve elektronike dhe informatike.

Instalime dhe shitje te sistemeve te sigurise, ruajte objektesh me sisteme elektronike dhe GPS, marketing dhe kerkim tregu.

Shitje me pakice e shumice per kancelari dhe tonera.

Shitje me pakice dhe shumice te pajisjeve elektronike dhe kompjuterike.



Shitje te produkteve elektrike dhe sherbimi i instalim/riparimet per sistemeve elektrike".

Shoqeria sipas nevojave te aktivitetit ka te drejten e ushtrimit te çdo aktiviteti te ligjshem, te lejueshem per formen e shoqerise, e cila nuk ndalohet me ligj.

NENI 4

Selia e Shoqërisë

Shoqeria ka seline ligjore:

DURRES Lagjja nr.7, Rruga Aleksander Goga, Objekt me nr.pasurie 15/373, Zona Kadastrale 8512

Shoqeria mund te hape filiale, dege apo perfaqesi ne te gjithe territorin shqiptar dhe jashte tij.

NENI 5

Kapitali i Shoqërisë

Kapitali themeltar i shoqërisë përbëhet nga kontributi në para i ortakut themelues të kësaj Shoqërie në lekë. Kapitali themeltar i shoqërisë eshte **100.000 Leke** (njeqindmije)lekë dhe përbehet nga 1 (nje) kuote.

Z. Elvis FAMA është zotërues e 1 kuote, me 100 % pjesmarrje në kapitalin e shoqërisë ne vleren 100.000 leke.

NENI 6

Kohëzgjatja e shoqërisë

Afati kohor i zhvillimit të aktivitetit të shoqërisë është i papërcaktuar dhe fillon me regjistrimin e saj në QKB.

NENI 7

Organet Drejtuese

Duke ju referuar ligjit nr. 9901, datë 14/04/2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", organet drejtuese të shoqërisë janë si më poshtë vijon:

1. Asamblea e Përgjithshme e Ortakëve – organi më i lartë vendimarrës;
2. Administratorët – Organi ekzekutiv dhe administrativ i Shoqërisë.


Elvis Fama

Organizimi dhe funksionimi i këtyre organeve është përcaktuar në statutin e shoqërisë. Shoqëria administrohet nga një Administrator, i cili do të zgjidhet për një afat 5 vjecar, me te drejte riemerimi..

Administratori i Shoqërisë do të jetë Z. Elvis FAMA për një afat 5 vjecar, me te drejte riemerimi..

Shoqëria përfaqësohet para çdo organi administrativ, gjyqësor, enti publik apo privat dhe në marrëdhënie me të tretët nga Administratori, i cili do të ushtrojë këto të drejta në përputhje me Statutin e shoqërisë dhe legjislacionin në fuqi.

NENI 8

Ortaku themelues mund të vendosi me vullnetin e tij, për pjesëmarrjen në Shoqëri të tjera dhe të krijojë çdo lloj aktiviteti tjetër privat, me përjashtim të kufizimeve të përcaktuara me ligj.

NENI 9

Organizimi dhe funksionimi, i shoqërisë, ngritja e degëve apo filialeve të saj, do të bëhet në përputhje me dispozitat e ligjit përkatës dhe statutit.

NENI 10

Ortaku detyrohet të ruajë sekretin e themelimit dhe të veprimtarisë së Shoqërisë. Të punësuarit dhe të ngarkuarit me drejtimin e Shoqërisë mbajnë përgjegjësi dhe detyrohen të zhdëmtojnë Shoqërinë për dëmet që i janë shkaktuar për faj të tyre gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre.

NENI 11

Legjislacioni i aplikuar

Aktiviteti i shoqërisë do të rregullohet nga Statuti i firmosur nga ortaket e Shoqërisë . Cdo gjë që nuk është parashikuar në Statut do të disiplinohet nga legjislacioni tregtar dhe nga dispozita ligjore në fuqi.

ORTAKU THEMELUES

Elvis FAMA

